



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË
ORGANIZUAR**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 28.04.2025

Lënda: Bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për çështjen ankim kundër vendimit nr. 744, datë 19.03.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Hajredinaj.

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 dhe 8 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Për kompetencë: Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese.

Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit!

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha kërkimet dhe prapësimet e palëve, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, për secilin shkak ankimi, në mënyrë të përmblodhur vlerëson si vijon:

I. Për vlerësimin e kriterit të pasurisë

1. Për shkakun ankimor lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 113,1 m², ndodhur në Tiranë, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur parashtrimeve të depozituara në seancën gjyqësore të datës 7.4.2025, ka depozituar edhe disa kontrata të lidhura ndërmjet shoqërisë " *** " sh.p.k. dhe palëve të treta.

1.1 *Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme*, pasi shqyrtoi shpjegimet dhe provat e depozituara, vlerëson se edhe në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e shkaqeve të ankimit lidhur me saktësinë e deklarimeve të tij mbi vlerën e blerjes së kësaj pasurie si dhe mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të përdorura për blerjen e saj. Subjekti i rivlerësimit edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, nuk dha shpjegime bindëse dhe deklaratimet e tij nuk duken se gjejnë mbështetje në raport me rrethanat e konstatuara, në kushtet kur:

1.1.1 Deklarimet e subjekti të rivlerësimit pranë ILDKPKI-së (në deklaratat periodike vjetore dhe atë vetting) si dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, lidhur me vlerën e kësaj pasurie, janë të ndryshme dhe kontradiktore, sikurse është trajtuar gjërësisht në ankim dhe parashtrime¹. Këto deklarime vlerësohen kontradiktore edhe në raport me aktet në dosje, nga të cilat rezulton se është paguar për llogari të shitësit shuma prej 38.000 euro, depozituar në *cash* sipas tre mandateve të arkëtimit depozituar nga vetë subjekti i rivlerësimit, çka së bashku me shumën e transferuar në llogarinë bankare të firmës ndërtuese, prej 34.510 euro, do të çonte në shumën totale prej 72.510 euro².

1.1.2 Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë kontradiktore edhe lidhur me destinacionin e shumës së marrë kredi nga *** Bank, pasi nga hetimi ka rezultuar se shuma prej 34.510 euro është kaluar në llogari të shoqërisë "***" sh.pk. me përshkrimin: *pagesë për blerje apartamenti Artan Hajredinaj* dhe në datë **10.2007 kjo shumë është tërhequr në *cash* nga administratori i shoqërisë ***. Ndërkohë vetë subjekti gjatë hetimit administrativ ka deklaruar se shuma e përfituar nga kredia bankare, është tërhequr dhe poseduar në *cash* nga ai vetë dhe përdorur për rikonstruksion/mobilim të këtij apartamenti. Pretendimi i subjektit, i bërë në një fazë të avancuar të procesit, në prapësime ndaj rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit, se kjo shumë i është dhënë *cash* nga administratori ***, mbeti në nivel deklarativ dhe i pambështetur në akte provuese. Të paprovuara mbetën dhe pretendimet e subjektit mbi kostot e mobilimit dhe mbulimin me burime të ligjshme të tyre³.

1.2 Deklarimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit mbi vlerën e blerjes dhe destinacionin e kredisë bankare, konsiderohen si përpjekje të tij për të paraqitur ndryshe këtë situatë dhe tregojnë për një sjellje të subjektit të rivlerësimit, e cila duket se nuk përkon me qëllimin e procesit të rivlerësimit për rikthimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë, problematika këto që duhen trajtuar nga Kolegji së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit, në referencë të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të zbatimit të nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

1.3 Sa i përket burimeve të ligjshme të deklaruara të përdorura për blerjen e kësaj pasurie, vlerësohet se edhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën për sa trajtuar në ankim dhe në parashtrime, lidhur me burimin e deklaruar: *të ardhura nga shitja e pasurive nr.*/* dhe nr.*/*, me vendodhje ****, Tropojë, në vlerën 12.392.800 lekë, pasi:

¹ Nga aktet në dosje rezulton se është deklaruar sa vijon: (i) 75.000 euro deklaruar në Deklaratën "Vetting"; (ii) 65.000 euro në DV-2008; (iii) 40.000 euro paguar tek shoqëria ndërtuese, referuar përgjigjeve të pyetësorit standard; (iii) 34.510 euro paguar nëpërmjet transaksionit bankar të datës **10.2007.

² Ndërkohë referuar kontratës së kredisë bankare, në nenin 1 të saj specifikohet se Banka bie dakord ti japë kredimarrësit kredi në monedhën euro në shumën 35.000 euro për rikonstruksion/blerje dhe investimi i kredimarrësve është në shumën 30.000 euro, pra në total 65.000 euro.

³ Në përfundim, subjekti ka pretenduar se kosto e mobilimit është 13.000 euro është pjesë e kredisë bankare në shumën 35.000 euro, pretendim të cilin Komisioni në përfundim e ka vlerësuar të besueshëm, ndërkohë subjekti në përgjigje të pyetësorit standard ka deklaruar mobilim në vlerën 600.000 lekë, në D-Vetting deklaroi vlerën 30.000 euro për mobilim dhe punime ndërtimore, nga aktet në dosje ka rezultuar dhe përfitimi i një kredie nga *** në shumën 5.000 euro e cila gjithashtu deklarohet nga subjekti se është marrë me qëllim mobilimin e këtij apartamenti.

1.3.1 Referuar akteve të administruara në dosje, pasuritë e llojit vresht, me nr. 1/1 dhe nr. 1/2, rezulton të jenë shitur për vlerën totale 12.392.800 lekë, me një çmim rreth 8-herë më të lartë së çmimi i blerjes së tyre, prej 1.500.000 lekë, vetëm 4 muaj përpara shitjes.

1.3.2 Edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e shkaqeve të ankimit lidhur me diferencën e ndjeshme të çmimeve të shitjes dhe blerjes së këtyre pasurive, për një periudhë të shkurtër kohore dhe shpjegimet e subjektit nuk duken bindëse. Akti i paraqitur prej subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim, raporti i vlerësimit i shkurtit 2024, vlerësohet se është hartuar në funksion të procesit të rivlerësimit dhe për këtë arsye duhet që të merret me rezervë në këtë proces, qëndrim ky i mbajtur dhe nga Kolegji në raste të ngjashme. Nisur dhe nga vlera e lartë e çmimit të shitjes, nuk u evidentua ndonjë transaksion bankar apo gjurmë tjetër e të ardhurave të përfituara nga kjo shitje, e rrjedhimisht, mbetet i dyshimtë fakti i likuidimit të çmimit të shitjes *në dorë* për një vlerë të tillë (referuar përcaktimeve në kontratë), apo dhe mënyra si këto fonde, në vlerë të konsiderueshme, janë administruar dhe ruajtur nga subjekti i rivlerësimit.

1.3.3 Për më tepër, nga aktet në dosje ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, në momentin e përfitimit të këtyre të ardhurave, vazhdonte të kishte ekspozim në një kredi marrë pranë Fondit të Financimit të Zonave Malore (FFZM), me interes të lartë, 15%, kredi të cilën duket se e ka shlyer vetëm në *shtator 2007*, rreth *një vit* pas përfitimit të të ardhurave nga këto shitje. Gjithashtu nga aktet në dosje ka rezultuar se subjekti, edhe pas shitjes së këtyre pasurive, ka vazhduar të aplikojë dhe të përfitojë kredi bankare, si për apartamentin në Tiranë, ashtu dhe për qëllime të tjera (kredi për mobilim apo overdrafte bankare), çka tregon për pamundësi financiare të tij për të mbuluar investimet/shpenzimet me të ardhura të tij⁴.

1.3.4 Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, paprovuar mbeti dhe mundësia financiare e blerësit, *** ***, pasi bazuar dhe në aktet e depozituara nga vetë subjekti i rivlerësimit, konfirmohet ekzistenca e aktivitetit ekonomik të blerësit, por nuk është administruar asnjë e dhënë mbi fitimet/të ardhurat e realizuara nga ky i fundit.

1.3.5 Sikundër trajtuar gjerësisht dhe në ankim, vlerësohet i pabazuar edhe konkluzioni i Komisionit, mbi evidentimin e mundësisë së kursimit⁵ deri më datë ** 3.2007, vlerësuar se ka shërbyer si burim për këstet e paguara pas datës së fillimit të detyrës, arsyetim ky, që ka bërë të ulet ndjeshëm pamjaftueshmëria financiare e konstatuar. Subjekti i rivlerësimit, nuk ka depozituar deklaratë përpara fillimit të detyrës pranë ILDKPKI-së (që do të duhej të depozitohej brenda muajit prill të vitit 2007 referuar datës së emërimit në detyrë). Ndërkohë, në deklaratën format “*Para fillimit të*

⁴ Përvëç kontratës së kredisë bankare për blerje/rikonstrukcion apartamenti në Tiranë, nga aktet në dosje kanë rezultuar dhe: Kontratë kredie bankare me *** në emër të bashkëshortes datë ** 1.2007, për shumën 800.000 lekë; kontratë huaje në llogarinë rrjedhësë pranë *** në emër të *** ***, datë **, 1.2008 për shumën 80.000 lekë; kontratë huaje në llogarinë rrjedhësë pranë *** në emër të *** ***, datë **, 2.2010 për shumën 210.000 lekë; kontratë overdrafti pranë *** në emër të *** ***, datë **, 7.2011 për shumën 220.000 lekë, etj.

⁵ Evidentuar në shumën prej 2.077.302 lekësh që vjen dhe si rezultat i përfshirjes së të ardhurave nga shitja e dy tokave të llojit “vresht”.

detyrës", dorëzuar në ILDKPKI në datë 19.3.2008, konsideruar si deklarata e parë e subjektit, nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar posedim të kursimeve në *cash* me burim pikërisht nga këto transaksione shitjeje.

1.3.6 Subjekti nuk ka deklaruar posedim të kursimeve *cash* me burim nga shitja e dy pasurive si më sipër, as në deklaratat e dorëzuar në ILDKPKI në tetor 2014, ku është përpjekur të qartësojë/sistemojë mungesën e deklarimit para fillimit të detyrës në vitin 2007, duke bërë të pa mbështetur këtë prezumim të Komisionit.

1.4 Në përfundim për këtë pasuri, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, nuk provoi të kundërtën e barrës së provës mbi vlerën e blerjes së pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 113,1 m², ndodhur në Tiranë dhe burimet e ligjshme të deklaruara të përdorura për blerjen e saj, duke mos arritur nivel të besueshëm, sipas parashikimeve të nenit D, pika 3 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës.

2. Për shkakun ankimor lidhur me të ardhurat e deklaruara nga shitja e pasurive "Njësi shërbimi", ndodhur në Bajram Curri, vlerësojmë se edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën për sa trajtuar gjerësisht në ankim dhe në parashtrimet e seancës së datës 7.4.2025, pasi edhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, mbeti e provuar se:

2.1 Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta në deklaratat periodike vjetore lidhur me këto pasuri. Në deklaratën e parë të pasurisë dorëzuar në ILDKPKI në datë ** .3.2008, deklaroi vetëm pasurinë nr. */* +*- ** me sipërfaqe 105,8 m², blerë në vlerën 1.600.000 lekë dhe shtesë 222 m² + kat, për të cilën deklaroi shpenzime në shumën 2.259.351 lekë, dhe nuk rezultoi të ketë deklaruar blerjen e pasurive të tjera, që më pas janë bashkuar dhe mbi të cilat është investuar kjo pasuri. Nuk rezultoi që në deklaratat e pasurisë në vijim, subjekti të ketë deklaruar ndryshime lidhur me këtë pasuri.

2.2 Sipërfaqja e ndërtimit e deklaruar nga subjekti në deklaratën e parë të pasurisë në datë ** .3.2008 prej 222 m²+ kat, nuk përputhet me sipërfaqen faktike të pasurisë shtesë, prej 392,59 m², e cila është dukshëm më e madhe.

2.3 Vlera e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit shpenzuar për kryerjen e investimit në këtë pasuri, prej 2.259.351 lekë ose rreth 5.755 lekë/m², rezultoi ndjeshëm më e ulët se kostoja e ndërtimit në qytetin e Tropojës për vitin 2007 referuar EKB-së, në vlerën 26.734 lekë/m². Nisur nga sipërfaqja e konsiderueshme e shtuar dhe faktit se investimi është realizuar nga një shoqëri ndërtuese, bazuar dhe në metodologjinë dhe standardin e Kolëgjit, vlerësohet se mbetet i pambështetur konkluzioni i Komisionit mbi reduktimin e ndjeshëm të kostonë së investimit nga 13.219.017 lekë (përlllogaritur në rezultatet e hetimit administrativ) në 6.720.969 lekë (përlllogaritur pas vlerësimit të shpjegimeve të subjektit). Nisur nga diferenca e ndjeshme midis kostonë së ndërtimit të deklaruar dhe pasqyruar në preventiv me çmimet referuese të EKB-së, në mungesë të ndonjë akti tjetër provues mbi vlerën reale të investimit të kryer, parë kjo në raport me sipërfaqen e konsiderueshme të ndërtimit, vlerësohet se pretendimet e subjektit edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj mbetën të paprovuara dhe në nivel deklarativ. Në këto kushte vlerësohet se përlllogaritja e vlerës së investimit, duhet të kryhet sipas çmimeve

referuese të EKB-së për sipërfaqe ndërtimi, sikurse është llogaritur nga Komisioni në analizën paraprake vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit me rezultatet e hetimit administrativ.

2.4 Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore edhe *lidhur me kohën e kryerjes* së këtij investimi, pasi në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI, subjekti ka deklaruar se investimi *ka përfunduar në vitin 2008*, ndërsa gjatë hetimit administrativ ka pretenduar se investimi është përfunduar *deri në shkurt të vitit 2007*. Ky pretendim i subjektit jo vetëm bie ndesh me aktin e kolaudit depozituar në dosje të hetimit, i cili referon vitin 2008⁶, por vlerësohet i pabesueshëm përfundimi i investimit për një periudhë 3 mujore⁷, referuar edhe sipërfaqes së konsiderueshme të ndërtimit.

2.5 Kontradiktore mbetën dhe deklarimet e subjektit *lidhur me burimin e krijimit* të këtyre pasurive, pasi në deklaratën e parë të pasurisë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi: *të ardhurat nga vëllëzërit në Angli dhe Zvicër*, ndërsa gjatë hetimit administrativ të Komisionit subjekti ka deklaruar se *si burim për investimin në shtesë, i cili ka përfunduar në datën ** .2.2007, kanë shërbyer të ardhurat e shitjes së pasurive nr. 1/1 dhe nr. 1/2, dhe kredia e marrë në atë periudhë pranë Shoqërisë së Parë Financiare të Zhvillimit (FAF-së)*, për të cilën deklaroi se i ka dalë nga kujtesa.

2.6 *Lidhur me dhurimin e pasurisë shtetasit *** dhe kostot e ndërtimit të pretenduara* të mbuluara prej tij, vlerësojmë se edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, mbetën të paprovuara pretendimet e subjektit, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar as në deklaratën Vetting dhe në asnjë prej deklaratave të pasurisë ndër vite, investimin e pretenduar të kryer nga ky shtetas, si dhe nuk ka provuar as gjatë hetimit administrativ me akte të kohës, pretendimin e tij se investimi në këto njësi tregtare, është kryer nga shtetasi ***. Për më tepër rezulton se me aktin "*deklaratë për heqje dorë...*" nr. *** / ** datë* .11.2006, bashkëpronarët e pasurisë truell me sipërfaqe 140,7 m², një prej të cilëve dhe shtetasi *** , kanë hequr dorë nga bashkëpronësia kundrejt vlerës 300.000 lekë, paguar nga subjekti i rivlerësimit.

2.7 Në përfundim, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm lidhur me *pasurinë "Njësi shërbimi"*, duke u ndodhur kështu në kushtet e parashikuara nga neni 61 pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka mbajtur qëndrime kontradiktore për të dhënat e deklaruara rreth pasurive të mësipërme, në kundërshtim me detyrimin kushtetues të parashikuar në nenin D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 e 32 të ligjit nr. 84/2016, çka bën të pamundur kontrollin e plotë lidhur me këto pasuri.

2.8 Përveç sa më sipër, nga aktet e administruara ka rezultuar se të ardhurat nga shitja e pasurive nr. */* - ***, dhe nr. */* - **/*, kanë shërbyer kryesisht si burim për krijimin e kursimeve në llogarinë bankare në vlerën 80.055 usd në *** Bank,

⁶ Datën * .9.2008, referuar datës kur është mbajtur procesverbali i kolaudit sipas lejes së shfrytëzimit nr. * , datë * .11.2008.

⁷ Pretendohet se ndërtimi ka përfunduar në shkurt 2007, ndërkohë që leja e ndërtimit për këtë objekt mban datën * .12.2006.

deklaruar në deklaratën Vetting dhe për dhënien e dy huave, shtetasve *** *** në shumën 30.000 euro dhe *** *** në shumën 19.000 usd. Në këto kushte, pamundësia e kontrollit lidhur me pasurinë "Njësi shërbimi", të ardhurat nga shitja e të cilave (në vitin 2016) kanë shërbyer si burim krijimi për llogarinë bankare pranë *** Bank dhe huatë e dhëna në vitin 2016, afektojnë ligjshmërinë e krijimit të këtyre të fundit.

2.9 Rethanat e konstatuara si më sipër, duhen trajtuar nga Kolegji eventalisht së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit, nën frymën e nenit 4, pika 2 të ligjit nr.84/2016, në kuadër të aplikimit të nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, si cenim i besimit të publikut të sistemi i drejtësisë.

3. Për shkakun ankimor lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 80,6 m², ndodhur në Bajram Curri, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka depozituar aktet si vijon: (i) Vërtetimin nr. *** prot., datë **3.2025 nga shkolla 9-vjeçare " *** " Dajt; (ii) Vërtetimin nr. *** prot., datë **3.2025 nga shkolla 9-vjeçare " *** " Dajt; dhe (iii) 2 vërtetime nr. *** prot., datë **.01.2017, nga Njësia Administrative Dajt.

3.1 Referuar parashtrimeve të subjektit dhe akteve të mësipërme depozituar në Kolegj, vlerësohet se edhe gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën për sa trajtuar gjerësisht në ankim dhe në parashtrimet në seancën e datës 7.4.2025, pasi:

3.2 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pronësinë/posedimin e kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë dorëzuar pranë ILDKPKI-së në datë **3.2008 dhe në asnjë prej deklaratave periodike vjetore pasuese në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga ligji nr.9049/2003, i ndryshuar. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pronësinë/posedimin e kësaj pasurie as në deklaratën Vetting, dokument i cili është hartuar nga ligjvënësi, me qëllim plotësimin nga ana e subjekteve të rivlerësimit dhe korrigjimin e pasaktësive në mënyrën e deklarimit ndër vite, përmes së cilës asetet dhe burimet e krijimit të tyre duhet të deklarohen *plotësisht* dhe të justifikohen ligjërisht. Ky detyrim i subjekteve buron nga dispozitat kushtetuese të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe parashikimet e ligjit nr. 84/2016, që përcaktojnë në mënyrë të qartë detyrimin e subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur/të tjerë të lidhur me të, për të deklaruar me saktësi në deklaratën "Vetting" dhe për të justifikuar vërtetësinë e deklarimeve mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë.

3.3 Deklarimet e subjektit të rivlerësimit mbi këtë pasuri, për herë të parë vetëm gjatë hetimit administrativ, vlerësohen kontradiktore, pasi në përgjigje të pyetësorit standard subjekti deklaroi se kjo pasuri është blerë nga motra e tij, ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr.2 të Komisionit, ai deklaroi se kjo pasuri është likuiduar prej tij ndaj të motrës, që në vitin 2005. Gjatë hetimit administrativ subjekti ka deklaruar se për këtë apartament ka paguar shumën 500.000 lekë, por nuk ka paraqitur dokumentacion provues për të provuar kohën dhe shumën e paguar, ndërsa në kartelën e pasurisë në emër të subjektit të rivlerësimit të administruar në dosjen e ASHK-së, referohet vlera 2.248.740 lekë.

3.4 Për sa më sipër arsyetuar, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimet ligjore të parashikuara në ligjin nr. 84/2016 për deklarimin e pasurisë objekt analize, duke u ndodhur kështu në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me këtë pasuri. Gjithashtu, në kushtet kur nga aktet në dosje nuk rezulton të jenë administruar akte që të provojnë kohën e përfitimit/likuidimit të kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit dhe vlerën e paguar prej tij, vlerësohet se pretendimet e subjektit të mbeten në nivel deklarativ dhe nuk mundësojnë kontrollin e organeve të rivlerësimit, lidhur me ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie.

4. Për shkakun ankimor lidhur me pasurinë apartament me sipërfaqe 72 m², ndodhur në Shëngjin, në pronësi të vëllait *** ** vlerësojmë se edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën për sa trajtuar gjerësisht në ankim dhe në parashtrimet e seancës së datës 7.4.2025, në kushtet kur mbeti e provuar se:

4.1 Subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “*** - ***” sh.p.k., datë **12.2007, në cilësinë e porositësit, duke u sjellë kështu si posedues i vetëm i ligjshëm i pasurisë deri në vitin 2019, kur është lidhur kontrata e shitjes në emër të të vëllait *** **. Këto veprime juridike, janë bërë në mungesë të një akti përfaqësimi, prokure, e cila referuar përcaktimeve të parashikuara në Kodin Civil mbi të drejtën e përfaqësimit, do të saktësonte të drejtën e subjektit të rivlerësimit për të kryer veprime juridike në emër e për llogari të një personi tjetër, vëllai në këtë rast, sikundër duket se ka vepruar subjekti në raste të ngjashme të përfaqësimit të të afërmeve⁸.

4.2 Në emër të subjektit të rivlerësimit ka rezultuar dhe kontrata e lidhur për furnizimin me energji elektrike, për të cilin subjekti ka kërkuar ndryshimin e emrit në kontratën me këtë operator, vetëm në datë **9.2017⁹.

4.3 Përveç nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes, rezulton se subjekti ka kryer edhe pagesën/depozitimin në *cash* në arkën e shoqërisë, të kështit datë **12.2007 (kohë në të cilën ushtronte detyrën e gjyqtarit).

4.4 Nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar këtë marrëdhënie juridiko/financiare, të krijuar dhe zhvilluar pa titull përfaqësimi, si në formularët e deklarimit të pasurisë dorëzuar në ILDKPKI për periudhën 2008-2016, ashtu dhe në Deklaratën “Vetting”, si dhe nuk ka qartësuar këtë marrëdhënie as në vitin 2014, i thirrur në ILDKPKI.

4.5 Sa më sipër, duke konsideruar faktin se për këtë pasuri subjekti ka vepruar me tagra të plota posedimi deri në vitin 2019, kur është lidhur kontrata e shitblerjes nga i vëllai, në mungesë të një akti ligjor përfaqësimi, ka përdorur pasurinë rregullisht për pushimet vjetore sipas deklarimeve të tij dhe ka rezultuar abonent në kontratat e energjisë elektrike deri në vitin 2017¹⁰, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit më së paku ka kryer deklarim të pasaktë për këtë pasuri në deklaratat periodike vjetore dhe atë

⁸ Vëllait tjetër **, apo të motrës **, apo të motrës **.

⁹ Konfirmuar me shkresë kthim përgjigje të FSHU nr. **/ *prot., datë **10.2023.

¹⁰ Konfirmuar me shkresë nr. **/ *prot., datë **10.2023 e FSHU, bashkëlidhur së cilës admistrohet një kërkesë me shkrim dore e nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, ku referohet se ndryshimi është bërë në vitin 2016.

Vetting, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar dhe ligji nr. 84/2016.

4.6 Përveç sa më sipër, nisur nga dyshimet e Komisionit, për të cilat i është kaluar dhe barra e provës, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të provonte burimet e ligjshme të të vëllait *** ***, të cilat edhe në përfundim të këtij procesi, vlerësohet se mbetën të paprovuara në mënyrë shteruese.

4.7 Konkluzioni i Komisionit se: [...] fakti se Komisioni është në pamundësi objektive për të kryer një analizë të mirëfilltë financiare të vëllait të subjektit, i cili ka jetuar në Mbretërinë e Bashkuar që në vitin 1999, në përfundim të procesit nuk mund të arrihet në përfundimin se z. *** *** ka qenë në pamundësi financiare për të blerë apartamentin [...], nuk është në përputhje me frymën e ligjit dhe qëllimin e këtij procesi. Nga verifikimi i akteve të vëna në dispozicion nga subjekti, në përgjigje të barrës së provës, nuk u provua në mënyrë shteruese as burimi i ligjshëm i të vëllait *** *** nga punësimi në Mbretërinë e Bashkuar dhe as mënyra se si këto fonde janë sjellë në shtetin shqiptar¹¹.

4.8 Në vlerësimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, çështjet e trajtuara më sipër duhet të analizohen dhe trajtohen nga Kolegji në vlerësim tërësor, së bashku me shkaqet e tjera trajtuar në ankimin e datës 14.6.2024, në kuadër të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

5. Për shkakun ankimor lidhur me kredinë e marrë nga Fondi i Financimit të Zonave Malore (FFZM), Dega Tropojë, në shumën 3.000.000 lekë, (përfutur datë 2.8.2006 dhe mbyllur në dt. 7.9.2007), vlerësojmë se edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegji, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën për sa trajtuar gjerësisht në ankim dhe parashtrimet e seancës së datës 7.4.2025, pasi:

5.1 Pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se si burim për shlyerjen e parakohshme të kredisë, kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e pasurive sipas kontratave të shitjes së nënshkruara në maj 2007 si dhe prezumimi i Komisionit, se të ardhurat e përfutura nga shitja e pasurive, mund të jenë gjeneruar përpara datës së përpilimit të kontratave të shitjes, mbeten të pambështetura në akte provuese.

5.2 Nisur dhe nga sa trajtuar dhe konkulduar më sipër, mbi pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë apartament banimi me sip. 113,1 m² ndodhur në Tiranë dhe shlyerjes së pagesave për të gjatë vitit 2007, pretendimi i subjektit mbi përdorimin e të ardhurave nga këto shitje, konsiderohet i pambështetur.

5.3 Përveç sa më sipër, referuar dhe deklarimit të vetë subjektit në deklaratën periodike vjetore dorëzuar në datën 27.10.2014 (në të cilën duket se ka deklaruar për 31.12.2007), ku subjekti ndër të tjera ka deklaruar dhe posedim në cash të shumës 3.300.000 lekë, shtuar gjendje cash në banesë me të ardhurat nga shitja e apartamenteve, pretendimet e tij gjatë hetimit administrativ mbi përdorimin e të

¹¹ Sikundër është provuar pjesërisht për transfertën e bashkëshortes së të vëllait në llogari të subjektit të rivlerësimit me përshkrimin për blerje banese.

ardhurave nga kjo shitje për shlyerjen e parakohshme të kredisë në vitin 2007, vlerësohen jo të besueshme.

5.4 Sa më sipër, në kuadër dhe të mungesës së deklarimit në kohë reale të detyrimeve dhe pasurive të luajtshme e të paluajtshme nga ana e subjektit në vitin 2007 dhe mungesës së deklarimit përpara fillimit të detyrës, dorëzuar në kohë reale në organet përgjegjëse, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me këtë detyrim dhe shlyerjen e parakohshme të tij, duke u gjendur kështu në kushtet e parashikuara në nenin 61 pika 3 dhe 5 e ligjit nr. 84/2016.

6. Për shkakun ankimor lidhur me lidhur me kursimet në cash, deklaruar në shumën 10.000 euro, vlerësojmë se deklarimet e subjektit gjatë hetimit administrativ në Komision mbi pakësimin/përdorimin e kursimeve cash gjatë periudhës 2011-2016, nuk përputhen me deklarimet e tij në deklaratat periodike vjetore, të cilat në këtë proces, referuar nenit 32 pika 5 e ligjit nr. 84/2016, kanë vlerën e provës¹².

6.1 Sa më sipër bazuar dhe në jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Kolegjit lidhur me kursimet cash, çmojmë si të pabazuar analizën e kryer nga Komisioni dhe pakësimin e kursimeve në cash në shumën 700.000 lekë në vitin 2014. Llogaritja e kursimeve në cash në analizën financiare të këtij viti, sipas deklarimit të subjektit në DV-2014, ndryshon rezultatin financiar të këtij viti, duke evidentuar mungesë të burimeve të ligjshme të subjektit dhe personave të lidhur me të për mbulimin e shpenzimeve të vitit 2014, në shumën – 445.876 lekë.

6.2 Për sa më sipër, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm duke u gjendur kështu në kushtet e parashikuara nga neni D pika 3 dhe 5 e aneksit të Kushtetutës dhe vlerësohet se çështjet e trajtuara më sipër, duhet të analizohen dhe trajtohen nga Kolegji në vlerësim tërësor së bashku me shkaqet e tjera trajtuar në ankim, në kuadër të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

II. B. Lidhur me profesionalizmin dhe etikën

II. B/1. Vlerësimi i aftësive profesionale

7. Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, *Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme*, vlerëson se në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e shkaqeve të ankimit për çështjet e mëposhtme:

7.1 *Lidhur me Denoncimin II¹³ (rasti i kërkesës se të dënuarit *** ***)*, subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e depozituara në seancën gjyqësore të datës 7.4.2025, ndër të tjera, ka prapësuar se: [...] *rasti konkret lidhet ngushtësisht me mënyrën e interpretimit të ligjit sipas bindjes time të brendëshme, pa u ndikuar nga*

¹² Në DV-2014 subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar pakësim të kursimeve cash në shumën 700.000 lekë, përkundrajt pretendimit të tij gjatë hetimit administrativ. Në këtë deklaratë janë deklaruar shpenzime mobilimi në shumën 600.000 lekë dhe shpenzime për energji elektrike në shumën 300.000 lekë, por nuk rezulton të jetë deklaruar burimi i krijimit të këtyre shpenzimeve apo pakësimi i kursimeve cash.

¹³ Shih denoncimin nr. *** prot., datë **5.2022 dhe nr. *** prot., datë **7.2021, ku ankuesit pretendojnë se subjekti i rivlerësimit në kundërshtim me ligjin ka dhënë vendimin nr. ** datë *4.2020, me objekt "Ujje dënim" që i përket kërkesës së të dënuarit *** ***. Komisioni, ka vendosur transferimin e kësaj çështje pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore.

asnjë faktor tjetër, në respektim të atributit që Kushtetuta i ka dhënë Gjykatës për të zgjidhur një kërkesë sipas vlerësimit të gjyqtarit të çështjes, e pashoqëruar kjo zgjidhje me akte apo sjellje që diskreditojnë figurën e gjyqtarit. Çdo pretendim për zbatim të gabuar të ligjit procedural apo material penal është kompetencë e gjykatës më të lartë, siç dhe ka ndodhur në rastin konkret të shqyrtuar nga Gjykata e Apelit për shkak të ankimit të paraqitur nga IEVP-ja përkatëse [...].

7.1.1 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi ka paraqitur në cilësinë e provës shkresën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nr. ***/** prot., datë **.1.2025 me lëndë “Njoftim për pezullimin e hetimit” e shoqëruar me Vendimin e ILD-së nr. ***/** prot., datë **.1.2025, në të cilën, ndër të tjera, referohet: [...] *Pezullimi i hetimit disiplinor të filluar me iniciativë me vendimin nr. ***/* prot., datë **.11.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndaj magjistratit z.Artan Hajredinaj ... deri në dhënien e vendimit të formës së prerë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit* [...].

7.1.2 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, lidhur me këtë shkak ankimi, vlerëson se edhe pas shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit dhe rrethanat e rastit mbetën të njëjta. Ndryshe nga sa ka vendosur Komisioni për transferimin e kësaj çështje, vlerësojmë se vendimi nr.**, datë *.4.2022 nuk duhej të transferohej për inspektim të shkeljeve pranë organit kompetent, në juridiksionin e zakonshëm disiplinor, por duhej të vlerësohej së bashku me gjetjet e tjera në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.

7.1.2.1 Ashtu siç ka arsyetuar edhe Gjykata e Apelit Shkodër, në analizë të nenit 63, ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar, vërehet se kushti i parë që mundëson uljen e dënimit është përcaktimi i statusit të kërkesës, si i dënuar. Sipas kërkesës rezulton se ***, ka kërkuar uljen e dënimit për periudhën *.7.2016 deri më *.6.2019, periudhë në të cilën ai ishte në gjendje paraburgimi, *pra nuk ishte i dënuar*. Shtetasi, konsiderohet i dënuar vetëm në ato raste kur vendimi i dënimit merr formë të prerë. Kërkesi ***, i dënuar konsiderohet që nga data *.6.2019, datë në të cilën është lënë në fuqi vendimi i dënimit të tij, nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda. Pikërisht se nuk kishte statusin e të dënuarit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për vendimin e formës së prerë, vetëm më datë *.7.2019. Për sa kohë, nuk vërtetohet kushti bazë, qenia e kërkesës *** i dënuar gjatë periudhës për të cilën ai kërkon uljen e dënimit, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte rrëzuar kërkesën për ulje dënimi.

7.1.2.2 Duke mbajtur në konsideratë dhe rëndësinë e arsytimit të vendimeve, si një garanci për procesin e rregullt ligjor¹⁴, vlerësohet se arsytimi i dhënë në këtë rast nga subjekti i rivlerësimit, ka mangësi në drejtim të njohurive ligjore dhe *aftësisë për të interpretuar ligjin dhe analizuar jurisprudencën*¹⁵. Subjekti është në kushtet e mungesës së një argumentimi ligjor të drejtë, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga neni 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

¹⁴ Shihni vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 24, datë 25.4.2016; nr. 73, datë 16.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁵ Nuk ka mbajtur në konsideratë vendimin e Gjykatës së Lartë nr. nr.00-2021-440 datë 29.6.2021

7.1.2.3 Sa më sipër, vlerësojmë se të dhënat e mësipërme, duhen mbajtur në konsideratë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit në referim të nenit 61 pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

7.2 **Lidhur me Denoncimin IV¹⁶**, subjekti i rivlerësimit në parashtimet e depozituara në seancën gjyqësore të datës 7.4.2025, ndër të tjera, ka prapësuar se: [...] *gjatë gjykimit të zhvilluar nuk kam vendosur të thërras në cilësinë e personit të tretë Bankën, pasi gjatë gjykimit të çështjes nga tërësia e akteve të sjella nga përmbaruesi gjyqësor, kam vlerësuar se Banka ka pasur dijeni për vendimet e përmbaruesit gjyqësor dhe për faktin se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë po zhvillohej ky gjykim ... duke i kushtuar më shumë rëndësi zgjidhjes së drejtë të çështjes kam anashkaluar këtë veprim procedural ... vlerësoj se nuk mund të konsiderohet si mangësi e njohurive ligjore, vetëm se nuk kam thirrur në cilësinë e personit të tretë dikë për të cilin vendimmarrja e gjykatës nuk ka rol thelbësor dhe se zgjidhja në themel e çështjes është e njëjtë me zgjidhjen e dhënë nga Gjykata pas rigjykimit të kësaj çështje [...].* Subjekti i rivlerësimit, nuk ka paraqitur akte provuese lidhur me këtë shkak ankimi.

7.2.1 *Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme*, lidhur me këtë shkak ankimi, vlerëson se edhe pas shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit dhe rrethanat e rastit mbetën të njëjta. Pa kaluar në përsëritje, për sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 14.6.2024, vlerësojmë se në këtë rast nuk është formuar drejtë ndërgjyqësia dhe gjykimi në shkallë të parë është në shkelje të rregullave që disiplinojnë ndërgjyqësinë, pasi përveç shoqërive përmbarimore private, palë në proces duhet të ishte edhe Banka *** sh.a. (sot Banka *** sh.a.), e cila ka qënë pala kreditore në këtë procedurë përmbarimore dhe subjekt që çënohet nga pretendimet për pavlefshmëri të titullit ekzekutiv.

7.2.2 Për sa më sipër, vlerësohet se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, sipas kërkesave ligjore, si dhe ka treguar mangësi në kriterin e cilësisë së analizës dhe arsyetimit ligjor për të marrë vendime gjyqësore, kriteret të parashikuara në pikën 2 dhe 3, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016.

7.3 **Lidhur me Denoncimin V¹⁷**, subjekti i rivlerësimit në parashtimet e depozituara në seancën gjyqësore të datës 7.4.2025, ndër të tjera, ka prapësuar se: [...] *Me vendimin nr. ** , datë *.5.2018 kam vendosur. Pranimin e padisë. Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. **, datë *.3.2021, duke rrëzuar kërkesë-padinë. Kam për të sqaruar se nuk mund të komentoj vendimin e një Gjykate më të Lartë por si Gjyqtar jam i bindur se vendimmarrja ime ka qënë e drejtë dhe e bazuar në*

¹⁶ Shih denoncim nr. *** prot., datë *.6.2021, ku denoncuesi pretendon se vendimi nr. ** datë *.3.2021, me objekt pavlefshmëri e titullit ekzekutiv dhe kundërshtim i veprimeve përmbarimore, me të cilin subjekti ka pranuar kërkesë padinë, është me të meta procedurale dhe është dhënë në kundërshtim me ligjin, pasi nuk është formuar drejtë ndërgjyqësia. Sipas tij në kushtet kur është kërkuar pavlefshmëria e titullit ekzekutiv palë në gjykim duhet të ishte dhe "*** Bank" e cila ishte palë kreditore

¹⁷ Shihni denoncim nr. *** prot., datë *.8.2018, ku denoncuesi ngre pretendime për çështjen gjyqësore civile, me palë paditëse *** dhe *** dhe palë e paditur *** Bank sh.a. etj., me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute kontratë hipotekimi, konstatimin e pavlefshmërie absolute kontratë kredie dhe kundërshtimin e veprimeve përmbarimore. Subjekti në mënyrë të gabuar me vendimin nr. *** datë *.5.2018 ka pranuar padinë, pasi sipas tij, paditësit nuk legjitimohen për ngritjen e kësaj padie duke mos qënë bashkëpronarë.

prova.... Edhe pse është vendosur në hipotekë një pasuri me sipërfaqe totale 56.1 m² (sipërfaqja e apartamentit në fakt ishte 108 m², pasi pasuritë me sipërfaqe 56.1 m² dhe 59.1 m² ishin të bashkuara) veprimet e përmbaruesit janë shtrirë mbi të gjithë pasurinë e konkretisht edhe mbi pasurinë me sipërfaqe 59.1 m², pasuri në të cilën paditësit janë bashkëpronar të saj, pasi kjo shtesë është krijuar pas legalizimit të saj dhe ata përfitojnë nga ky ligj. Ky ka qenë dhe fakti që unë kam legjitimuar paditësit në këtë kërkim dhe ju kam dhënë të drejtë pasi kam vlerësuar se nga Banka nëpërmjet përmbaruesit ju kishte marrë pasuria 59.1 m² e cila nuk ishte vënë në hipotekë në momentin e marjes së kredisë [...]. Subjekti i rivlerësimit, nuk ka paraqitur akte provuese lidhur me këtë shkak ankimi.

7.3.1 *Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme*, lidhur me këtë shkak ankimi, vlerëson se edhe pas shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit dhe rrethanat e rastit mbetën të njëjta. Pa kaluar në përsëritje, për sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 14.6.2024, vlerësojmë të konstatojmë se në këtë rast Gjykata e Apelit Shkodër ka gjetur se vendimi nr.** datë **.5.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë është i pabazuar në ligj e në prova. Sikundër është arsyetuar në vendimin e gjykatës kontrolluese (apeli), paditësit *** dhe *** nuk kanë një të drejtë të ligjshme për të mbrojtur në këtë proces gjyqësor civil. Në kontratën e kredisë dhe të hipotekimit që ata kontestojnë me kërkesëpadi, rezulton se ata nuk kanë qenë palë pjesëmarrëse e nuk vërtetohet as që të jenë bashkëpronarë të pasurisë së paluajtshme të hipotekuar në favor të garantimit të kthimit të shumës së dhënë kredi.

7.3.2 Në përfundim, vlerësohet se arsyetimi i vendimit të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, tregojnë për mangësi sipas përcaktimit të ligjit 96/2016, neni 72, "Aftësia profesionale e gjyqtarit", pika 2 e tij, aftësisë për të interpretuar ligjin, si dhe pika 3 në aspektin e cilësisë së analizës dhe duhet të merren në konsideratë në vlerësimin e kriterit profesional.

8. Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e shkaqeve të ankimit. Në vlerësimin e **Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme**, veprimet e subjektit të rivlerësimit afektojnë kriterin e aftësisë profesionale, sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 72 pika 2 dhe 3 dhe nenin 75, pika 3 të ligjit nr. 96/2016. Problematikat e konstatuara më sipër duhen trajtuar nga Kolegji eventualisht së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit të datës 14.6.2024, në referencë të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të zbatimit të nenit 61, pika 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016.

9. **Lidhur me denoncimet në vijim**, në vlerësim të parashtrimeve dhe akteve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore të datës 7.4.2025, çmohet se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të bazuara, për sa trajtuar në vijim:

9.1 **Lidhur me Denoncimin I⁸**, subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e depozituara në seancën gjyqësore të datës 7.4.2025, ndër të tjera, ka prapësuar se: [...] *Kemi të bëjmë*

¹⁸ Shihni denoncim nr. ** prot., datë *.8.2023.

me vendime të dakortësuara nga të gjitha palët, ndaj të cilëve nuk është paraqitur ankimi, pra vendime të formës së prerë për dhënien e të cilëve kam gjykuar krahas provave dhe bindjes së brendshme të krijuar në ato gjykime ... gjatë kohës që kam gjykuar kërkesa që kishin të benin me këtë objekt kam pasur parasysh dhe një praktikë të konsoliduar në këtë gjykatë lidhur me qëndrimin dhe interpretimin e nenit 63 të ligjit nr.8329/1998. Ishte praktik të cilën unë e gjeta në atë gjykatë, pasi erdha nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe duke qenë se të gjithë gjyqtarët bënim të njëjtin interpretim e kam zbatuar si praktikë e konsoliduar [...].

9.1.1 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi ka paraqitur në cilësinë e provës 14 vendime të marra nga gjyqtarë të tjerë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë me objekt "Ulje dënimi".

9.1.2 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në vlerësim të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve të depozituara lidhur me këtë shkak ankimi vlerëson se qëndrimi i subjektit të rivlerësimit mbi zbatimin e drejtë të nenit 63 të ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", i ndryshuar është i bazuar, pasi në 5 vendimet shkak ankimi, me objekt "Ulje dënimi", rezulton se është aplikuar ulje e pjesshme e dënimit në masën 60 dhe 45 ditë, praktikë e konsoliduar kjo referuar akteve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj.

9.2 Lidhur me Denoncimin III¹⁹, subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e depozituara në seancën gjyqësore të datës 7.4.2025, ndër të tjera, ka prapësuar se: [...] Lidhur me këtë vendimarrje të KPK ka mbajtur qëndrimin e saj ILD pasi me vendimin nr. ***/* datë *.11.2024 është vendosur arkivimi pas shqyrtimit të kësaj çështjeje, pasi nuk ka prova të mjaftueshme për krijimin e dyshimit të arsyeshëm për fillimin e procedimit disiplinor. Vendimi nr. * , datë *.7.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë nuk ka sjellë asnjë pasojë, por çmoj se është një garanci më shumë për palët në proces dhe për Gjykatën e Apelit që ka në shqyrtim çështjen [...].

9.2.1 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi ka paraqitur në cilësinë e provës: (i) shkresën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nr. ***/* prot., datë *.11.2024 me lëndë "Njoftim mbi vendimin e arkivimit pas shqyrtimit fillestar për një nga çështjet e transferuara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit" e shoqëruar me Vendimin e ILD-së nr. ***/* prot., datë *.11.2024, në të cilin, ndër të tjera, referohet: [...] Arkivimin pas shqyrtimit fillestar të çështjes së dytë të transferuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit [...]. (ii) Vërtetim nr. *** prot., datë *.3.2025 i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë i cili konfirmon se pranë kësaj gjykate ka ardhur për gjykim çështja penale me nr.: *** - *** - **/- 2022 çështje, nr. ** Akti datë regjistrim * .6.2022 që i përket të pandehurit *** i akuzuar për kryerjen e veprës penale "Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor", parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal. Kjo çështje është në pritje të planifikimit. (iii) Shkresa nr. *** prot., datë *.3.2025 e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë bashkëlidhur së cilës është përcjellë fotokopje e njëzuar me origjinalin të vendimit nr. */* , datë *.3.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

¹⁹ Denoncim nr. *** prot., datë *.10.2023.

9.2.2 *Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme*, në vlerësim të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve të depozituara lidhur me këtë shkak ankimi, vlerëson se pretendimi i subjektit mbi vendimmarrje të drejtë qëndron, në kushtet e vlerësimit të kësaj procedure nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe vendimmarrjes së tij për arkivimin duke arsyetuar se shqyrtimi dhe vlerësimi i pretendimeve të palëve dhe provave gjatë një procesi gjyqësor dhe interpretimi i ligjit sipas bindjes së brendshme në gjykimin e një çështjeje është atribut i pushtetit gjyqësor dhe trajtimi i pretendimeve për zbatim të gabuar apo mosrespektim të legjislacionit procedural ose material gjatë shqyrtimit gjyqësor është kompetencë e gjykatave më të larta.

9.3 *Lidhur me Denoncimin VI*²⁰, subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e depozituara në seancën gjyqësore të datës 7.4.2025, ndër të tjera, ka prapësuar se: [...] *Lidhur me këtë vendim kam për të sqaruar se kemi të bëjmë me një vendim të formës së prerë në të cilin është aplikuar neni 53 i Kodit Penal ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji. Në këtë vendimmarrje pavarësisht se për shkak të ngarkesës së lartë cedoj në arsyetimin e vendimit sa i përket kushteve të aplikimit të nenit 53 të K.Penal, qëllimi i të gjithë arsyetimit është vlerësimi se pse nuk është pranuar kërkesa e prokurorit për mos aplikimin e nenit 59 të K.Penal. Duke qenë se në fokus të arsyetimit i kam kushtuar rëndësi faktit të mospranimit të kërkesës së prokurorit për aplikimin e nenit 59 të K.Penal, nuk i kam kushtuar shumë rëndësi, arsyetimit të kushteve të aplikimit të nenit 53 të K.Penal, pasi kam vlerësuar se këto kushte plotësohen nga i pandehuri [...]. Subjekti i rivlerësimit, nuk ka paraqitur akte provuese lidhur me këtë shkak ankimi.*

9.3.1 *Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme*, në vlerësim të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë shkak ankimi, vlerëson se mangësitë e konstatuara lidhur me arsyetimin mbi aplikimin e nenit 53 të K. Penal nuk janë në atë masë sa të konsiderohen penalizuese për efekt të procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, pasi janë pa pasoja dhe në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka rrëzuar kërkesën e prokurorit për aplikimin e nenit 59 të K.Penal, nuk tregojnë për ndonjë favorizim të mundshëm të të pandehurit nga ana e subjektit të rivlerësimit.

9.4 *Lidhur me Denoncimin VII*, subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e depozituara në seancën gjyqësore të datës 7.4.2025, ndër të tjera, ka prapësuar se: [...] *E konsideroj të drejtë dhe të bazuar vendimmarrjen e KPK, sa i përket vendimit me nr. *** datë **3.2021 me të pandehur * * ku arsyetohet se unë në cilësinë e subjektit të rivlerësimit, gjatë arsyetimit të vendimit pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe bindjes së brendshme kam arritur në të njëjtin konkluzion me atë të prokurorit. Siç rezultoi i pandehuri duke mos qenë dakord me vendimin e subjektit e ka ankimuar atë duke kërkuar pafajësi, për rrjedhojë nuk mund të konkludohet se subjekti ka mbajtur qëndrim favorizues. Vendimi nr.*** datë *.9.2018 me të pandehur **.*** dhe vendimi nr. *** datë **.3.2018 me të pandehur * *, të dy këto vendime janë të formës së prerë dhe nuk janë kontestuar nga palët [...].*

²⁰ Denoncimi nr. *** prot., datë **, 08.2023.

9.4.1 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi ka paraqitur në cilësinë e provës vërtetim nr. *** prot., datë * .3.2025 i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë i cili konfirmon se pranë kësaj gjykate ka ardhur për gjykim çështja penale me nr. *** - *** -*** 2021 çështje, nr. *** Akti, datë regjistrimi **.5.2021 që i përket të pandehurit *** , i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Fallsifikim i dokumenteve në bashkëpunim”, “Fallsifikim i vulave, i stampave ose i formularëve në bashkëpunim”. “Shpërdorim i tokës”, “Pastrim i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”. Kjo çështje është në pritje të planifikimit.

9.4.2 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në vlerësim të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve të depozituara lidhur me këtë shkak ankimi vlerëson se pretendimet e subjektit mbi këto vendimmarrje qëndrojnë, pasi rezulton se subjekti në argumentet e veta me të drejtë i është kërkuar përfundimtar të prokurorit.

9.4.3 Në lidhje me pretendimet e ngritura në këtë denoncim për çështjen në ngarkim të shtetasve *** dhe *** se janë dhënë dënime të ulëta, si dhe për çështjen penale për shtetasin *** , vlerësohet se prapësimet e subjektit qëndrojnë dhe lidhur me këto dy çështje penale ndajmë të njëjtin qëndrim me atë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

9.4.4 Në rastin e çështjes së parë subjekti i rivlerësimit duhet të ishte treguar më i kujdesshëm në redaktimin e vendimit, por këto elementë nuk janë të tilla që të çënojnë aftësinë profesionale të subjektit. Ndërsa, në rastin e çështjes së dytë, subjekti i rivlerësimit iu është referuar me të drejtë akuzës së prokurorit si dhe qëndron pretendimi sipas të cilit ai ka miratuar një marrëveshje që ishte nënshkruar me vullnetin e lirë të pjesëmarrësve në proces.

II. B/2. Çështje të referuara nga organet ligjzbatuese

9.5 Lidhur me dosjen gjyqësore që i përket çështjes penale me subjekt procedural shtetasin . *** , subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e depozituara në seancën gjyqësore të datës 7.4.2025, ndër të tjera, ka prapësuar se: [...] *Pikërisht si kërkesa e të arrestuarit për zëvendësim mase dhe kërkesa e prokurorit për caktim mase janë shqyrtuar nga Gjykata sipas kohës së paraqitjes datës dhe orës së caktuar. Me vendimin nr.** datë * .03.2021 është vendosur: Zëvendësimi i masës së sigurimit “Arrest në burg” me masën e sigurimit “Arrest në shtëpi”, Vendimi i Gjykatës është bazuar në provat e paraqitura ashtu dhe në kërkimin e vetë prokurorit, i cili është dakord për masën e sigurimit “Arrest në shtëpi”. Neni 244/3 i K.P.Penale ka përcaktuar se gjykata nuk mund të caktojë masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori. Kemi të bëjmë me vendim të dakordësuar nga të gjitha palët, ndaj të cilit nuk është paraqitur ankim, pra vendim i FORMËS SË PRERË për dhënien e të cilit kam gjykuar krahas provave dhe bindjes së brendshme të krijuar në atë gjykim. ... ky shtetas është arrestuar më datë **.11.2021 në orën 17.00 për veprën penale “Largimi i të burgosurve nga vendi i qëndrimit”, parashikuar nga neni 323/1 të K.Penal dhe po për arsye shëndetësore nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë është caktuar masa e sigurimit “Arrest në shpi” pikërisht për arsye shëndetësore [...].*

9.5.1 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi ka paraqitur në cilësinë e provës dispozitivin e vendimit nr.***_2021_**, datë **.11.2021, si dhe procesverbalin e seancës gjyqësore datë 15.11.2021 për të arrestuarin *** **

9.5.2 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në vlerësim të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve të depozituara lidhur me këtë shkak ankimi vlerëson se pretendimi i subjektit mbi këto vendimmarrje qëndron. Zëvendësimi i masës së sigurimit nga "Arrest në burg" me masën e sigurimit "Arrest në shtëpi", rezulton i bazuar në provat e paraqitura ashtu dhe në kërkimin e vetë prokurorit, i cili është shprehur dakord për pranimin e kërkesës dhe për zëvendësimin e masës së sigurimit duke caktuar masën e sigurimit "Arrest në shtëpi" për shtetasin *** **

9.6 Lidhur me dosjen penale që i përket vendimit nr. *** datë *.9.2021, subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e depozituara në seancën gjyqësore të datës 7.4.2025, ndër të tjera, ka prapësuar se: [...] Gjatë arsyetimit të këtij vendimi dhe vlerësimit se pse kam caktuar një masë të tillë, kam arsyetuar se nuk rezulton se ky shtetas është i përfshirë në prodhim dhe shitje e narkotikëve ... nga vendimi përfundimtar për zgjidhjen në themel të çështjes referuar vendimit nr. **/*, datë **.1.2023 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ku i pandehuri *** ** është deklaruar fajtor vetëm për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal dhe është deklaruar i pafajshëm për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal. Po ashtu i pandehuri tjetër *** ** është deklaruar i pafajshëm për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal sipas vendimit nr.*** (**), datë **.7.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, pra në thelb masa e sigurimit e aplikuar ndaj tyre ishte në raport të drejtë me rrethanat e çështjes [...].

9.6.1 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi ka paraqitur në cilësinë e provës (i) Vendim nr. **/**, datë **.1.2023 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë (vendim themeli i të miturit në konflikt me ligjin *** **), dhe (ii) vendim nr.*** (**), datë **.7.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë (vendim themeli i *** **).

9.6.2 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në vlerësim të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve të depozituara lidhur me këtë shkak ankimi vlerëson se pretendimi i subjektit mbi këtë vendimmarrje për caktim mase sigurie qëndron dhe nuk konstatohen problematika të tilla që mund të ndikojnë vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

IIB/3 Në lidhje me një konflikt të mundshëm interesi.

9.7 Në lidhje me një konflikt të mundshëm interesi dhe marrëdhëniet me shoqërinë " *** ** " sh.p.k dhe administratorin e saj shtetasin *** ** alias *** **, subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e depozituara në seancën gjyqësore të datës **.4.2025, ndër të tjera, ka prapësuar se: [...] Lidhur me mungesën e heqjes dorë në këtë rast, dhe konkretisht në çështjen nr. ***/** datë **.10.2021 me palë Paditës: *** **, E Paditur: Shoqëria " *** ** " sh.p.k, me administrator *** **, me Objeka: Detyrimin e të pandehurit për Lirim Dorëzim Sendi etj. Kam për të sqaruar se kjo çështje është regjistruar me datë **.10.2021 dhe

nëpërmjet shortit elektronik më ka rënë për shqyrtim mua Gjyqtarit Artan Hajredinaj (në këtë periudhë Kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ishte znj. **.*)). Ndërkohë, tashmë kishte një praktikë (vendim gjyqësor për mospranimin e kërkesës për heqje dorë i marrë nga Kryetarja e Gjykatës znj. *.*) për konstatimin e mosekzistencës së shkaqeve për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes penale me palë Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me Objekt: Vleftësim arrestimi dhe caktim mase sigurimi ndaj të arrestuarit *****) (. ***) pasi në vitin 2019 kërkesa për heqje dorë nuk ishte pranuar nga gjykata. Për këtë arsye, kam vlerësuar se paraqitja e një kërkesë për heqje dorë nga gjykimi i çështjes civile, me palë paditëse *****) . E Paditur: shoqëria *****) sh.p.k. me administrator *****) me objekt: Detyrimin e të paditurit për lirim dorëzim sendi etj, për shkak të nënshkrimit të një kontrate sipërmarrjeje në vitin 2007 (në kushtet kur ishim në të njëjtat shkaqe dhe kërkesa i drejtohej të njëjtës kryetare gjykate) do të konsiderohej sërish si e pabazuar nga gjykata [...].

9.7.1 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak ankimi ka paraqitur në cilësinë e provës (i) E-mail i datës **.3.2025 i Kancelares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë i cili referon periudhat kohore në të cilat gjyqtarja *****) ka qenë në funksionin e kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

9.7.2 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në vlerësim të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve të depozituara lidhur me këtë shkak ankimi, vlerëson se pretendimi i subjektit mbi mungesën e konfliktit të interesit, qëndron duke marrë parasysh faktin se në momentin e gjykimit të çështjes civile që i përket vendimit nr. *** datë **.4.2022 me palë paditës *****) , i paditur shoqëria “ **** - **** ” sh.p.k me objekt lirim dorëzim sendi, ku është vendosur pushimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit, marrëdhënia kontraktuale midis shoqërisë “ ****-**** ” sh.p.k dhe palës blerëse të apartamentit kishte përfunduar pasi që në vitin 2019 ishte lidhur kontrata e shitjes dhe në këtë mënyrë nuk ka patur ndonjë shkak përjashtimi apo heqje dorë nga ato të parashikuara në nenet 72 dhe 73 të Kodit të Procedurës Civile.

9.7.3 Gjithashtu, vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit në çështjen në fjalë vlerësohet se është e drejtë dhe nuk konstatohen problematika lidhur me këtë vendimmarrje. Vendimi për pushimin e çështjes për shkak të mungesës së palës paditëse pa shkaqe të arsyeshme, ka qënë në përputhje me kërkesat e nenit 179/1 të Kodit të Procedurës Civile.

III. Kërkimi i ankimit.

10. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

11. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016;

12. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa "b", të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 744, datë 19.3.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Hajredinaj.

DREJTUESI I PROKURORISË

Altin DUMANI

PROKURORI I AUTORIZUAR

Klodjan BRAHO